



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 394/2022

Datë: 16 mars 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.25 dhe nenit 16 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe në bazë të Planit Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, në takimin e mbajtur me datë 16 mars 2022, mori këtë:

VENDIM

- I. Themelohet Grupi Punues për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, në përbërje prej:
 1. Ariana Shajkovci, Anëtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës – Kryesuese;
 2. Besim Kelmendi, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit – Anëtar, dhe
 3. Margarita Gjocaj, Zyrtare e Lartë për Integritim Evropian në SKPK – Anëtare.
- II. Obligohet Grupi Punues që raportimin për zbatimin e Planit Strategjik ta realizojë siç parashihet me Planin Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqet zyrtare të KPK-së dhe PSH-së.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Ti dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.